



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 1074/20  
1121/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE: “EKO-DDD”- Ferizaj, si dhe OE: “VLERA”SHPK - Shtime, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë, më datën: 25.01.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “EKO-DDD”- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë.

**II. REFUZOHET**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “VLERA”SHPK-Shtime lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë.

**III. ANULOHET**, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**

**IV.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues : “EKO-DDD”- Ferizaj, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “VLERA”SHPK-Shtime, refuzohet si e pa bazuar të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës .

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues “EKO-DDD”- Ferizaj që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “EKO-DDD”- Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 10.12.2020 me nr. 1074/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe dezinsektimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 56.3, 59, 72 dhe 108/A , të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE “VLERA”SHPK-Shtime, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 21.12.2020 me nr. 1121/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dezinfektimi, dezinfektimi dhe dezinsektimi i institucioneve arsimore”, me numër të prokurimit: 616-20-3417-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 60, 69, dhe 72, të Ligjit për

Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “EKO DDD”

#### **Përgjigje në pretendimin nr.1**

Pretendimi kryesorë ankimore sipas ankesës nr. 1074/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-KK Prishtinë produkti me të cilin ka ofertuar OE në ueb faqe të prodhuesit shënon se afatin e përdorimit e ka dy vite, ndërsa sipas sqarimeve të marra nga prodhuesi afati përdorimit është 3 vite.

Sipas AK-së kjo nuk mund të jete e besueshme, pasi që në faqen zyrtare të te njëjtit qëndron edhe me tutje deklarimi se afati i përdorimit për këtë produkt është dy vite.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimeve ankimore, e në veçanti pas analizimit të kërkesave të dosjes së tenderit vlerëson se askund në kërkesa të dosjes nuk është caktuar se sa duhet të jetë afati i përdorimit.

Kërkesa decidive tek aneksi 1 i dosjes :

#### *Deratizimi*

*Kriteret bazë të këtijë aktiviteti duhet të jenë:*

*o Për Deratizimin e objekteve të institucioneve shkollore duhet të përdoren preparate Deratizues-rodenticid - antikuagidant të gjeneratës së dytë.*

*Preparatet Deratizuese duhen të kenë:*

*Çertifikatë të A-Testit,*

*Afat të përdoritnit,*

*Lista teknike e sigurisë*

*Lejen për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.*



Siq mund të shihet nga kërkesa e dosjes nuk është caktuar kohëzgjatja e afatit të përdorimit. Andaj në pajtim me dispozita ligjore të LPP-së, asnjë kërkesë e cila nuk ka qenë paraprakisht e specifikuar në dosje të tenderit nuk mund të përdoret si arsye për eliminim.

Neni 7, par.6, pika “v” :

*“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë...*

*(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies”.*

Përveç këtyre që u cekën më lart, sqarimi i pranuar në AK nga ana prodhuesit e konfirmon atë që shkruan në certifikatë sa i përket afatit të përdorimit, andaj si ekspert shqyrtues e kemi të pamundur të konfirmojmë të kundërtën e asaj që ka deklaruar prodhuesi, dhe nëse AK ka dyshime për vërtetësinë e dokumentit në fjalë (certifikatës dhe afatit të përdorimit të shënuar në certifikatë) atëher mendojmë se AK do duhej të drejtohet organeve kompetente.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se gjatë vlerësimit të ofertave AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së.

#### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË QE ANKUES “VLERA”

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesor sipas ankesës 1121/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE, ku sipas AK arsyeja e eliminimit të OE është sin ë vijim :

*“OE Vlera edhe pas sqarimeve të kërkuara është vertetuar se ka pasur ndërhyrje në dokumentin MSDS me no 100057 mbishkrimi Certificate of Analysis dhe ndërhyrje në datën e skadencës të produktit .Në këtë rast sipas specifikave është kërkuar afati i përdorimit A-Testit faqe 227 dhe 228”*

Në rastin konkret vlerësojmë se pavarësisht afatit të përdorimit, është kontestues emërtimi i dokumentit si “Certificates of Analysis” (certifikatë e analizës).

Vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë “certifikatë e A testit”, pasi që dokumentet MSDS janë dokumente që përgaditen nga vet prodhuesit, ndërsa certifikatat e A testit janë dokumente që lëshohen nga një palë tjetër ( psh laboratore të testimit) për prodhuesin.

Bazuar në këtë vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe Certifikatë e A testit apo certifikatë e analizës siq e prezanton OE ankues.

Për dallim nga dokumenti në ofertë të OE ankues, në dokumentin MSDS nr. 100057 i cili mund të gjendet

në internet askund nuk shënon emërtimi "Certificate of Analysis".

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është i pabazuar.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues:** Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues "Eko DDD" të aprovohet e bazuar, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e OE.Vlera", të anulohet vendimi i AK-së për anulim dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 06.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se kanë pranuar ekspertizën dhe **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues

Konfirmoj pranimin e ekspertizës dhe njëkohësisht deklarojmë se nuk pajtohemi me mendimin dhe përgjigjet e ekspertit, të cilat nuk kane asgjë të përbashkët me ekspertize profesionale. Kjo argumentohet me argumentet e paraqitura ne vijim:

E para është përgjigje dhe konstatim joprofesional te thuhet se Autoriteti Kontraktues duhet te paraqes afatin e perdorimit ne dosje,kur çdo zyrtar qe merret me çeshtjet e prokurimit dhe me sherbimet e kerkuara ne dosje duhet ta dij se afati i perdorimit te çdo produkti jepet nga prodhuesi e jo nga ai qe e kerkon te njejtin,respektivisht Autoriteti Kontraktues ka te drejten te kerkoj qe produkti te mos jete me afat te skaduar e jo te drejten per te caktuar afatin e perdorimit.Per kete arsye edhe eshte kerkuar qe preparatet te kene ne mes deshmive tjera edhe deshmi per afatin e perdorimit;

E dyta për arsyet qe ndoshta vetëm eksperti e din nuk ka analizuar dy certifikatat e dorëzuara nga paraqitësi i ankesës te cilat janë krejtësisht te njëjta dhe ne te njëjtat ndryshon vetëm afati i skadimit dhe kjo nuk don dije te larte profesionale për te kuptuar se ne njëren nga ta është ndërhyrë dhe është falsifikuar;

E treta komunikimet me prodhuesin jane perseritur per arsyen e thjeshte se i njehti ne rastin e pare ka dhene nje pergjegje te dyshimte dhe nuk ka komentuar nderhyrjen ne çertifikata;

E katerta,prodhuesi duke verejtur se per ne falsifikimi me çertifikaten eshte mjaft i qarte heren tjeter ka deklaruar se nuk ka asnje produkt te tij qe eshte me afat te perdorimit ne Kosove.

Dhe ne baze te gjitha ketyre parashtrohet pyetje:kur falsifikimi i ankuesit eshte i qarte si eshte e mundur qe nje ekspert ta pranoj ankesen e tij te bazuar dhe se nese i pranohet ky falsifikim atehere pse nuk veprohet njejte edhe me ankuesin tjeter,pasi qe jam shume i sigurve se nderhyrja e tij ne dokument paraqet nderhyrje shume me te parendesishme se sa nderhyrja ne falsifikimin e afatit te perdorimit te preparatit.

Shpresoj se Paneli Shqyrtues do t'i analizoj drejt keto argumente dhe do te merr Vendim meritor.



Operatori Ekonomik "EKO DDD", me datë: 06.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe kërkojm nga paneli shqyrtues te marr vendim qe lenda te kthehet ne rivlerësim dhe AK gjate rivlerësimit te respektoj dispozitat ligjore te LPP-së

Operatori Ekonomik "EKO DDD", me datë: 07.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **SQARIM** lidhur me mendimin e ekspertit shqyrtues

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues nuk qëndron siq pohon ai se experti ka dhënë konstatim joprofesional se AK në Dosje të tenderit dhe në Njoftimin për kontratë nuk e ka paraqitur afatin e përdorimit prej 1 apo 2 vite por vetëm të jetë me afat përdorimi. Dhe për preparatet në mes dëshmime tjera ka kërkuar dëshmi për afatin e përdorimit të cilën edhe e kemi ofruar ne.

Lidhur me arsyetimin tjetër te AK konkretisht zyrtarit përgjegjës të prokurimit z. Zekë Bardhaj ku thotë "dy certifikatat e dorezuara nga paraqitesi i ankeses te cilat jane krejtesisht te njejta dhe ne te njejta ndryshon vetem afati i skadimit dhe kjo nuk don dije te larte profesionale per te kuptuar se ne njerin nga ta është ndërhyrë dhe eshte falsifikuar" si është e mundur të qëndrojë ky arsyetim apo i është ngatërruar me operatorin tjetër pasi që në Vendimin e datës 03.11.2020, ku vet AK thotë (citim): Lidhur me pretendimin se dy dokumentet identike, ne te cilat ndryshon vetem afati i skadimit, jane dokumente valide te prodhuesit ju sqarojme se pretendimi eshte i bazuar, pasi qe ne kemi kerkuar lidhur me kete konfirmim nga i njejti dhe kemi pranuar sqarimin se dokumentet jane leshuar nga ai dhe artikulli i permendur ne certificate ka afat trevjeqar te perdorimit pra deri me VII 2021.

Habitemi shume me Autoritetin Kontraktues qe ne e-mailin e derguar ka perdore fjalen falksifikim per dokumentet tona te cilat i ka verifiku dhe ka deshmite se nuk ka vend as per dyshim, por fatmiresisht te gjitha deshmite ekzistojne. E për krahasimin e bere me operatorin tjetër nuk do koment pasiqe te gjitha deshmite dhe vendimet e AK tregojne se dokumentet e tij jane te manipuluara, ndersa per Ne te gjitha vendimet e AK-se tredojne se kane vertetuar origjinalitetin e dokumentit ne fjale por se fundmi eshte shume e quditshme se qka ka ndodhe. Dyshojme se i eshte ngaterruar.

Të gjitha sqarimet e dhëna sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues të cilat janë të ekspozuar në e-prokurim me vete kanë dëshmitë të cilat nuk mund të ndryshohen nga askush pasi që kanë ekzistuar edhe para dorëzimit të ofertës edhe në kohën kur ato kanë ndodhur.

Shpresoj qe Paneli Shqyrtues do të analizojë të gjitha kërkesat, sqarimet, dhe dëshmitë dhe te marrë një Vendim të drejtë.

Operatori Ekonomik "VLERA" Shpk, me datë: 07.01.2021, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues

Ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, pasi që konkluzionet e nxerrura nga ai për këtë lëndë të prokurimit janë jo profesionale duke pasur parasysh pa njohurin për fushën e Dezinfektimit, si dhe të njeanshme.

Kerkojm nga Paneli Shqyrtues që të analizohet me vëmendje ankesa jone dhe të mos merret për bazë analizat jo profesionale të Ekspertit shqyrtues

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.01.2021, përmes platformës elektronike Zoom, dhe ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,

njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

#### **Deklarimet e palëve:**

Seanca e mbajtur për dëgjimin e pretendimeve:

Kryetari i Panelit z.Blerim Dina, e hapi seancën për dëgjim të pretendimeve ankimore të OE-ve ankues Besim Zejnullahu B.I dhe OE. VLERA.

Deklarimet e OE-ve:

OE ankues Besim Zejnullahu B.I (Eko – DDD) deklaroi:

Në letrën standarde të lëshuar me 03 dhjetor 2020 nga AK-Komuna e Prishtinës, për ne si OE i eliminuar thotë se certifikata e analizave me. Nr.071801, komisioni ka kërkuar sqarim më të detajuar nga prodhuesi lidhur me certifikatën.

Prodhuesi deklaroi se përpara afati i këtyre produkteve Blok parafin Rudenicideve ka pasur afat 2 vite, kurse tani me paskan afat 3 vite, prodhuesi deklaroi se Rudenicid janë pa afat sepse që 3 vite nuk ka import të këtij prodhuesi nga Kosova.

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye, me këto nuk kemi qenë të pajtimit, prandaj nuk jemi pajtuar me komisionin e vlerësimit se na është bërë padrejtësi neve si Operator ekonomik duke e shkelur nenin 56.3 të LPP-se.

Ne si OE kemi bërë kërkesë për rivlerësim me dt.03 dhjetor 2020 dhe i kemi dëshmu Ak-se se importin e kemi bërë me dt.21 korrik 2018, ku kemi bashkangjitur DUD-in me numër Reference R-12203 të dt.21 korrik 2018 që i kemi bashkangjitur bashkë me kërkesë dhe i kemi tregu.



Deklarata e prodhuesit nuk qëndron sepse ka pas mundësi me ju ngatërru prodhuesit se nuk mundet me i mbaj të mend gjithë ata blerës të tij, kështu që importimi nuk ka qenë qe 3 vite, por ka qenë 2 vite nga data e ofertës që na e kemi ba. Në kërkesë ne kemi dyshu se prodhuesi mund të ketë ndonjë ndikim nga jashtë, pasi që gjatë vitit 2020 nuk kemi kontaktu me prodhuesin, nuk kemi pas komunikime me ta. Kështu që Autoriteti Kontraktues gjitha komunikimet që i kemi bërë gjatë vitit 2018, të cilat nuk munden me u ndryshu, Autoriteti Kontraktues i ka poseduar.

AK ka një përfundim të gabum që e ka quajtuar falsifikim dokumentin tonë, për arsye se: dokumentin që ne e kemi dorëzu, certifikata e analizave është lëshuar nga prodhuesi të cilën ne e posedojmë origjinal, ku ne e kemi dëshmu se si është pranë përmes emailave komunikues të cilat e vërtetojnë pranimin e atij dokumenti, si dhe vet Autoriteti Kontraktues e ka vërtetuar nga prodhuesi, përmes emailit e ka pranë që dokumenti është valid me vendimin e kërkesës për rishqyrtim të dt.03.11.2020, në të cilin thuhet:

Lidhur me pretendimin se dy dokumente identike në të cilat ndryshon vetëm afati i skadimit , janë dokumente valide të prodhuesit ju sqarojmë se pretendimi është i bazuar. Pasi që ne kemi kërku lidhur me këtë konfirmim nga i njëjti dhe kemi pranë sqarimin e dokumentit që janë lëshu nga ai(prodhuesi), dhe artikulli i përmendur ne certifikat ka afat 3 vjeçar të përdorimit, pra deri në korrik 2021.

Bazuar në këtë pretendim kërkoj që aktiviteti të kthehet në rivlerësim dhe këto dokumente të trajtohen si të pranueshme dhe parashtruesi i kërkesës të trajtohet si tenderues i përgjegjshëm dhe se është në pajtim edhe me kërkesat e tjera të dosjes.

Mirëpo pas një muaji me dt.03.12.2020, ka ardh vendimi kundër që lexova pak më parë.

Kështu që Komuna e Prishtinës nuk e ka bërë vlerësimin e ofertës sipas kriterëve të DT-së dhe NJK, por ka bërë një vlerësim jo sipas kriterëve për të cilën e ka shkel edhe nenin 56.3 të LPP-se.

Kështu që ne si Operator ekonomik jemi në gjendje tia dergojmë cdo organi.. qofte juve, qofte çdo organi tjetër që dokumentet e dorëzuara me ofertë janë dokumente që i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. Ne jemi OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë.

Deklarimi i ankuesit OE. "VLERA" deklaron:

Operatori tjetër njëherë e përmendi të fundit, pastaj e përmendi vendimin që u marr në fillim, e ndryshoj rendin e emailave të vendimeve. Kjo ka shumë rëndësi që në emailin e fundit Autoriteti Kontraktues e ka kërku prej prodhuesit përgjigjen është kjo që prodhuesi deklaron se afati përpara i këtyre ka qene 2 vite, tani është 3 vite.

Prodhuesi deklaron se Rodenticidi ne tregun tone është pa afat, pasi që 3 vite nuk ka import të këtij prodhuesi nga Kosova, e ka cek që 3 vite ska hy mall në Kosovë, kjo është shumë e rëndësishme edhe e ka marr eliminimin, kjo është arsyeja më e fortë.



Kryetari i panelit z.Dina ndërhyr dhe kërkon nga ankuesi që të sqarohet për veti, jo për Operatorin tjetër. Pra, nëse ju jeni më i lirë mendimi me dal të suksesshëm, por folni për veti, sepse ai (OE tjetër ankues) fol për veti.

OE Vlera (vazhdon): ne si OE vlera nuk jemi pajtu me vendimin e ekspertit, pasi që është mendim shumë i quditshëm për dokumentin. Përgjigjen MSDS që e ka dhënë në ekspertizë, kisha pas qef që të jetë eksperti Ilir Halili, pasi që ka thënë që në MSDS nuk ka të drejtë me ju bashkangjiti Certifikata e analizave, ka thanë eksperti kjo është e pavërtetë dhe nuk di ku është bazu eksperti.

Pasi që jam doktor i shkencave të mjekësisë askush nuk ka të drejtë me fol më shumë se unë, edhe ai (eksperti) ka thënë që certifikata e analizave të materialit, nuk guxon me ju bashkangjiti certifikata e analizave të materialit..

Une nuk di a e ka pyet naj operator ekonomik apo ku e ka marr kete përgjigje, kjo është përgjigje e gabume dmth gabimi i parë është këtu që ka dhënë përgjigje negative për ne.

Seni tjetër që është shume i rëndësishëm është që ne vendimin e pare Autoriteti Kontraktues na ka shpalle neve fitues si çmim me i lire dhe tenderi ekonomikisht me i përgjegjshëm.

Operatori ekonomik i ka bërë disa shpifje, tepër shpifje qe definitivisht me i lexu,,nuk di krejt dokumentet neve na i ka ba fallc.

Kur u ardh landa te ju ne OSHP, na jau kena bashkangjiti krejt qato pretendime qe i ka pas thane qe nuk i posedojmë pompat elektrike per dezinfektim, as dokumentacion as asgja. Na ja kemi bashkangjiti OSHP-se dikun 100 faqe dokumente per krejte ato qe i ka pretendu veq mos me u kthy lënda ne rivlerësim dhe mos me humb kohe kot e kot.

Lënda ka arrit me u kthy ne rivlerësim se kta ekspertet shqyrtues ja nuk po marrin informata sa duhet, ja po janë te ndikueshem eksperti shqyrtues e merr vendimin pra normalisht edhe paneli shqyrtues duke u mbështet te eksperti shqyrtues.

Kryesuesi Dina: Kemi qene ne kohe pandemi dhe nuk i kemi degju operatoret.

Shume mire qe këna fillu sot kryetar qe me dite edhe ju shpjegimin edhe mos me u bazu 100% te eksperti...une nuk jam i mendimit qe mendimi i ekspertit me shku bllanko se kam shume dyshime per kete pjese.

Pastaj me u kthy ne Autoritet Kontraktues..Autoriteti kontraktues i ka thane operatorit qe MSDS qe eshte nje Certifikate e sigurisë se mjeteve qe i përdorim , dmth. Sigurisë se materialit qe e përdorim,,dmth, NA e këna shkru datën edhe titullin, kjo u ba per arsye se ne Aneksin 1 te specifikacioni teknik te Komuna e Prishtines ka shkru qe duhet te ceket data, eshte ne Aneksin 1 te specifikacioni teknik .

Na e këna shkru datën ne menyre kompjuterike per shkak se nuk eshte shkru data ne MSDS, Na prej prodhuesit nuk e këna pranua te MSDS me date, qe eshte shume normale mos me u pranu me date, e Na e këna shenu datën tone.

Seni tjetër e këna shkru titullin ku ndodhet Certifikata e analizave eshte shkurtese sepse mbi 80 faqe eshte MSDS-ja, edhe qe normalisht te merr shume kohe me gjet veq dokumentin e MSDS-se, kjo eshte ba krejt per sqarim te Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti e ka vleresu kta si ndërhyrje ne dokument zyrtar.

Këtu janë dy gabime: MSDS nuk ka dokument zyrtar hiq, eshte dokument eshte flete e te dhënave te sigurisë se materialit, dmth, aty muj me ba nënshkrime sa te dush veq se une nuk muj me ja nderru asnjëherë materialit te dhënat , psh., ka sulfur me shume ose eshte me acidik ose me bazik..une nuk ja kum nderru ato sepse nuk kam asnjë arsye, te Autoriteti kontraktues i ka lyp qashtu qysh eshte produkti ashtu me dorezu.

Asnjë arsye na nuk kena pas me ndërhy ne MSDS dhe ne certifikate te analizave.

Seni tjetër pse Operatori ekonomik Besim Zejnullahu ka lobu shume me kthy kete lende ne rivlerësim, kur kthehet lënda ne rivlerësim i nderum kryetar krijohet nje komision i ri i Autoritetit Kontraktues,,ky komision i ri i autoritetit kontraktues u formu prej drejtorave te shkollave. Ky operator i ka mbi 5 vite qe i dezinfekton shkollat a je ka kupton,, e normalisht krejt drejtorat e shkollave e njohin se pijnje kafe me ta, edhe tash qysh munet komision vlerësues mu ba drejtori i shkollave e mos me pas mendim pozitiv per ta edhe mos me pas mendim pozitiv per operatorin tjetër, krejt qëllimi i këtij operatori u kane me kthy landen ne rivlerësim, me marr mendimin e jaranave te vet.

Kryetari i panelit (z.Dina) ndërhy: fol veq per veti se letrat flasin, pra veq arsyet e eliminimit per veti.

Operatori ekonomik (Vlera), po kryetar jam tu shku me ren arsyet e eliminimit i ceka qe kenë ato, edhe ti kallëzova pretendimet qe operatori ekonomik Besim Zejnullahu qe me kthy landen ne rivlerësim dhe pe rate e ka zgjat kete lande qe 1 vit per kot, a je ka kupton.

Sipas nenit 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese – na veq te Autoriteti kontraktues e kena nje kerkese ku ne nenin 72 thote: Dokumentacioni dhe informacioni shtese thotë kështu: AK mund te ftoj operatoret ekonomik per te plotësuar apo qartësoj certifikatat , dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenin 65-71 te LPP-se.

AK mundet me thane qe Autoriteti kontraktues nëse dokumenti i MSDS nuk eshte i qarte, mundeni me na dergu nje MSDS tjetër te produktit ose plotesone qata se po na doket e mangët.

Nene nuk na eshte kerku plotësimi sipas nenit 72 qe eshte dokumentacioni dhe informacioni shtese dhe na këtu kena nje kerkese prej autoritetit kontraktues ku ka gabu, kurse prej operatorit tjetër Besim Zejnullahu me informacion shtese e ka investigu, përmes emailave ka dal qe qertifikata e analizave te tyne eshte e



falsifikune zoti Kryetar, une ta bashkangjes certifikatën e analizave përmes emailit dhe e sheh qe e njëjta certifikate me nr.rendor me vule me krejt veq ju ka nderru data per me thane qata qe ka afat, ky nuk ka pas afat dhe e ka nderru veq datën per me pas afat.

Per fund fjalja e fundit qe zyrtarisht si përfaqësues ligjor i kompanisë VLERA, do te kërkoj me shkrim nga Autoriteti Kontraktues qe te pezullohet aktiviteti i prokurimit dhe AK ne OSHP per shkak te dokumentit fallc.

Autoriteti Kontraktues:

Nuk do ta zgjas me shume qëndron prapa vendimit per anulim te këtij aktiviteti, pasi qe edhe letrat flasin vet, kështu qe nuk do ta zgjas.

OE Besim Zejnullahu i kunderpergjigjet OE VLERA se une i kam ba te gjitha gjetjet qe i ka pas ne dosjen e tij OE. VLERA, ato gjetje i ka mshel sytë Autoriteti Kontraktues qe i kemi pa...nuk eshte problemi i jemi. Sa i përket MSDS nuk kemi pas asgjë me punën e MSDS, por ky dokument MSDS eshte shndërruar ne Certifikate te analizave, këtu shihet intervenimi i tij qe eshte, ky eshte falsifikim i plote 100%.

Per dyshimet qe i ka OE VLERA dhe Autoriteti kontraktues, janë organet kompetente qe mund ta vërtetojnë, pra eshte Forenzika qe merret dhe e vërteton ate dokument.

Nuk dyshoj se OE VLERA dyshon se eshte falsifikim, se ky ka pas dokumente me herët se ky e ka keqpërdor vulën e prodhuesit e kane vërtetu edhe organet prej Beogradit, qe janë te keqpërdorura, por tek e fundit le te mbet ne ndërgjegjen e tij.

Edhe diçka harrova me potencu, sic deklaroi OE VLERA, se kemi lidhje me Komunen e Prishtines, ..deklaroj se OE VLERA le ta gjen veq nje drejtor qe pin kafe apo han dreka me drejtorin e kompanisë (OE. Besim Zejnullahu), atëherë mujna me thane se kena bashkëpunim, pra nuk kena asnjë shok, as kerkan, nuk kena kurrfarë lidhje per qata cdo vjet ne kemi probleme per te marr nje kontrate se nuk kemi kerkan, nuk kemi lidhje..

Kerkoj lënda qe te kthehet ne rivlerësim dhe te shpallemi si OE i përgjegjshëm pasi qe jemi OE i përgjegjshëm.

OE VLERA vazhdim sqarimi, spo du me u marr me operatorin ekonomik, prej Ministrise se Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor ne e marrim nje leje, qe kena drejte me importu dmth. Rodenticid dhe krejte produktet dhe OE Besim Zejnullahu ska leje nga viti 2019 per import.

Ndërhyn përfaqësuesi i OE Besim Zejnullahu, ku e sqaron se kemi import per vitin 2018, qe e kemi edhe DUD-in.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se lidhur me ankesën e OE “EKO-DDD” – Ferizaj, konform ekspertit shqyrtues sipas ankesës nr. 1074/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-KK Prishtinë produkti me të cilin ka ofertuar OE në ueb faqe të prodhuesit shënon se afatin e përdorimit e ka dy vite, ndërsa sipas sqarimeve të marra nga prodhuesi afati përdorimit është 3 vite.

Sipas AK-së kjo nuk mund të jete e besueshme, pasi që në faqen zyrtare të te njëjtë qëndron edhe me tutje deklarimi se afati i përdorimit për këtë produkt është dy vite.

Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimeve ankimore, e në veçanti pas analizimit të kërkesave të dosjes së tenderit vlerëson se askund në kërkesa të dosjes nuk është caktuar se sa duhet të jetë afati i përdorimit.

Kërkesa decidive tek aneksi 1 i dosjes : *Deratizimi*

*Kriteret bazë të këtijë aktiviteti duhet të jenë:*

- o Për Deratizimin e objekteve të institucioneve shkollore duhet të përdoren preparate Deratizues-rodenticid - antikuagidant të gjeneratës së dytë.*

*Preparatet Deratizuese duhen të kenë:*

*Certifikatë të A-Testit,*

*Afat të përdorimit,*

*Lista teknike e sigurisë*

*Lejen për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.*

Siç mund të shihet nga kërkesa e dosjes nuk është caktuar kohëzgjatja e afatit të përdorimit. Andaj në pajtim me dispozita ligjore të LPP-së, asnjë kërkesë e cila nuk ka qenë paraprakisht e specifikuar në dosje të tenderit nuk mund të përdoret si arsye për eliminim.

Neni 7, par.6, pika “v” :

*“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë...*

*(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies”.*

Përveç këtyre që u cekën më lart, sqarimi i pranuar në AK nga ana prodhuesit e konfirmon atë që shkruan në certifikatë sa i përket afatit të përdorimit, andaj si ekspert shqyrtues e kemi të pamundur të konfirmojmë



të kundërtën e asaj që ka deklaruar prodhuesi, dhe nëse AK ka dyshime për vërtetësinë e dokumentit në fjalë (certifikatës dhe afatit të përdorimit të shënuar në certifikatë) atëherë mendojmë se AK do duhej ti drejtohet organeve kompetente.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se gjatë vlerësimit të ofertave AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform raportit të ekspertit të OSHP-se sqaron se OE ankues "EKO DDD", me ankesën nr. 1074/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-KK Prishtinë produkti me të cilin ka ofertuar OE në ueb faqe të prodhuesit shënon se afatin e përdorimit e ka dy vite, ndërsa sipas sqarimeve të marra nga prodhuesi afati përdorimit është 3 vite.

Kriteri i kërkuar:

Kërkesa decidive tek anekesi 1 i dosjes : *Deratizimi*

*Kriteret bazë të këtijë aktiviteti duhet të jenë:*

*o Për Deratizimin e objekteve të institucioneve shkollore duhet të përdoren preparate Deratizues-rodenticid - antikuagidant të gjeneratës së dytë.*

*Preparatet Deratizuese duhen të kenë:*

*Çertifikatë të A-Testit,*

*Afat të përdorimit,*

*Lista teknike e sigurisë*

*Lejen për importim dhe përdorim nga Ministria përkatëse.*

Siq mund të shihet nga kërkesa e dosjes nuk është caktuar kohëzgjatja e afatit të përdorimit. Andaj në pajtim me dispozita ligjore të LPP-së, asnjë kërkesë e cila nuk ka qenë paraprakisht e specifikuar në dosje të tenderit nuk mund të përdoret si arsye për eliminim.

Përveç këtyre që u cekën më lart, sqarimi i pranuar në AK nga ana prodhuesit e konfirmon atë që shkruan në certifikatë sa i përket afatit të përdorimit, andaj si ekspert shqyrtues e kemi të pamundur të konfirmojmë të kundërtën e asaj që ka deklaruar prodhuesi, dhe nëse AK ka dyshime për vërtetësinë e dokumentit në fjalë (certifikatës dhe afatit të përdorimit të shënuar në certifikatë) atëherë mendojmë se AK do duhej ti drejtohet organeve kompetente.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se gjatë vlerësimit të ofertave AK ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së

**OE ankues Besim Zejnullahu** e ka paraqitur në dosje dëshminë DUD-in dhe po ashtu ia ka dërguar AK-se emailin e pranuar nga prodhuesi, ku po ashtu AK e ka vërtetuar nga prodhuesi se produkti ka pasur afat 2 vite dhe tani me ka afat 3 vite, kështu që bazuar në datën e importit që ka OE Besim Zejnullahu (Eko-

DDD), me dt.21.07.2018, ku OE ankues përmes seancës degjimore deklaroi se ne si OE kemi bërë kërkesë për rivlerësim me dt.03 dhjetor 2020 dhe i kemi dëshmu AK-se se importin e kemi bërë me dt.21 korrik 2018, ku kemi bashkangjitur DUD-in me numër Reference R-12203 të dt.21 korrik 2018 që i kemi bashkangjitur bashkë me kërkesë dhe i kemi tregu, po ashtu edhe AK e ka vërtetuar përmes prodhuesit se dokumentet në fjalë (analizat) janë lëshuar nga prodhuesi, dhe po ashtu OE ankues deklaroi se i qëndron mbrapa dokumentacioneve sepse nuk ka asnjë ndërhyrje dhe janë organet kompetente që mund ta vërtetojnë origjinalitetin, po ashtu kete e ka vërtetuar edhe AK nga prodhuesi sipas kërkesës për rishqyrtim dhe sipas vendimit të AK-se të dt.03.11.2020.

Pra, edhe pse sipas raportit të ekspertit shqyrtues askund nuk është kërkuar sa produkti duhet të kete afat përdorimi, dhe cdo kërkesë jashtë kriterëve të FDT dhe Njoftimit për kontratë bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-së.

Po ashtu edhe Eksperti shqyrtues pas analizimit të pretendimeve ankimore, e në veçanti pas analizimit të kërkesave të dosjes së tenderit vlerëson se askund në kërkesë të dosjes nuk është caktuar se sa duhet të jetë afati i përdorimit.

Paneli shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor i OE ankues Besim Zejnullahu është i bazuar, dhe AK mund të vlerësojë sipas kriterëve të kërkuara në FDT dhe Njoftim për kontratë, dhe jo të vlerësojë jashtë atyre kriterëve sepse bie ndesh me nenin 56.3 të LPP-se.

Paneli konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në kriteret e kërkuar si në FDT dhe Njoftim për kontratë nuk e ka kërkuar askund në kriter garancionin e produktit, dhe për këtë eliminimi i OE nga kriteret që nuk janë kërkuar as në FDT as në NJK janë kriterë diskriminues sipas nenit 7 dhe nenit 56.3 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e **OE ankues "Vlera"** Paneli Shqyrtues sqaron se sipas përgjigjeve të dhëna në raportin e ekspertit shqyrtues sipas ankesës 1121/20 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE, ku sipas AK arsyeja e eliminimit të OE është si në vijim :

*"OE Vlera edhe pas sqarimeve të kërkuara është vërtetuar se ka pasur ndërhyrje në dokumentin MSDS me no 100057 mbishkrimi Certificate of Analysis dhe ndërhyrje në datën e skadencës të produktit .Në këtë rast sipas specifikave është kërkuar afati i përdorimit A-Testit faqe 227 dhe 228"*

Në rastin konkret vlerësojmë se pavarësisht afatit të përdorimit, është kontestues emërtimi i dokumentit si "Certificates of Analysis" (certifikatë e analizës).

Vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë "certifikatë e A testit", pasi që dokumentet MSDS janë dokumente që përgaditen nga vet prodhuesit, ndërsa certifikatat e A testit janë dokumente që lëshohen nga një palë tjetër (psh laboratore të testimit) për prodhuesin.

Bazuar në këtë vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe Certifikatë e A



testit apo certifikatë e analizës siq e prezanton OE ankues.

Për dallim nga dokumenti në ofertë të OE ankues, në dokumentin MSDS nr. 100057 i cili mund të gjendet në internet askund nuk shënon emertimi "Certificate of Analysis".

Ne seancen degjimore qe u mbajt perfaqesuesi I OE VLERA deklaroi se ne kemi nderhy me date, sepse MSDS-ja nuk e ka pasur daten citim: .... MSDS qe eshte nje Certifikate e sigurise se mjeteve qe i perdorim, dmth. Sigurise se materialit qe e perdorim, dmth, NA e kena shkru daten edhe titullin, kjo u ba per arsye se ne Aneksin 1 te specifikacioni teknik te Komuna e Prishtines ka shkru qe duhet te ceket data, eshte ne Aneksin 1 te specifikacioni teknik .

Na e kena shkru daten ne menyre kompjuterike per shkak se nuk eshte shkru data ne MSDS, Na prej prodhuesit nuk e kena pranua te MSDS me date, qe eshte shume normale mos me u pranua me date, e Na e kena shenu daten tone.

Seni tjetër e këna shkru titullin ku ndodhet Certifikata e analizave eshte shkurtese sepse mbi 80 faqe eshte MSDS-ja, edhe qe normalisht te merr shume kohe me gjat veq dokumentin e MSDS-se, kjo eshte ba krejt per sqarim te Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti e ka vlerësua këtë si ndërhyrje ne dokument zyrtar.

Pra, Paneli shqyrtues sqaron se vet OE VLERA deklaroi vet se ka ndërhyrë ne MSDS ku e ka shënua datën, po ashtu edhe ne Certifikatën e analizave ku e ka shkruar titullin.. Pra këtu vet deklaroi OE VLERA sepse dokumenti i prodhuesit ka qene pa date dhe kërkesa e AK te Aneksi 1 - specifikimi teknik ka qene qe dokumenti te jete me date.

Nuk ka te drejte OE te ndërhyjë ne dokumentin zyrtar qe e ka lëshuar një prodhues.

Pra, siç pretendon OE ankues "VLERA" se AK mund te kërkoj sqarime qe ta ndërrojmë certifikatën e analizave dhe MSDS sipas nenit 72 te LPP-së, Paneli shqyrtues sqaron se AK mund te kërkon sqarime ne ndonjë paqartësi por jo te ndërroj ndonjë dokument nga ajo qe është dorëzuar ne dosjen e tenderit. Pra, nuk mund te kërkohet dokument i ri pasi ai dokument është dorëzuar ne dosje.

Po ashtu edhe Eksperti shqyrtues ne raportin e tij thotë se Vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë "certifikatë e A testit", pasi që dokumentet MSDS janë dokumente që përgatiten nga vet prodhuesit, ndërsa certifikatat e A testit janë dokumente që lëshohen nga një palë tjetër (psh laboratorë të testimit) për prodhuesin.

Bazuar në këtë vlerësojmë se dokumenti MSDS nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe Certifikatë e atestit apo certifikatë e analizës siq e prezanton OE ankues.

Për dallim nga dokumenti në ofertë të OE ankues, në dokumentin MSDS nr. 100057 i cili mund të gjendet në internet askund nuk shënon emërtimi "Certificate of Analysis".

Pretendimi ankimor I OE ankues VLERA i hedhet i pa bazuar dhe çdo ndërhyrje ne dokumentet zyrtare sipas vërtetimit te AK-se dhe ekspertit te OSHP-se duhet te sanksionohet me ligjet ne fuqi.

Bazuar në gjitha këto që u cekën si më lart nga eksperti shqyrtues dhe sipas analizave per pretendimin ne fjale, Paneli shqyrtues sqaron se pretendimi ankimorë i OE ankues është i pabazuar.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së gjithashtu vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK – "KK Prishtinë"

1x1 OE "EKO DDD",

1x1 OE: "VLERA" SHPK

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.